

## GJYKATA THEMELORE PRIZREN

P.nr. 300/13

17 prill 2014

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prerë dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

### Në Emër të Popullit

Gjykata Themelore në Prizren, në trupin gjykues përbërë nga:

Gjykatësja e EULEX-it Anna Adamska – Gallant, Kryetare e Trupit Gjykues, Gjykatësi i EULEX-it Piotr Bojarczuk dhe gjykatësja i Kosovës Teuta Krusha, anëtarë të trupit gjykues, procesmbajtës Tarik Mripa, në lëndën penale kundër:

**Sh. K., ,**

**N. M., ,**

**M. S., ,**

**A. R., ,**

Akuzuar me aktakuzën ushtruar nga Prokuroria Speciale e Kosovës (“PSRK”), datë 07 gusht 2009 kundër tre të pandehurve të parë dhe aktakuza e PSRK-së e datës 30 shtator 2009 kundër A. R., aktakuzat e bashkuara më datë 20 tetor 2009, dhe ndryshuar nga PSRK më datë 24 mars 2014, për veprat penale të mëposhtme:

- 1) Kundër Sh. K., N. M., M. S. dhe A. R.: personat e akuzuar, duke vepruar në bashkëveprim si grup i mirë-organizuar dhe me qëllimin e përfitimit material të paligjshëm për veten e tyre, pa autorizim, janë marrë me transportin e substancave narkotike me qëllim shitjen e tyre. I akuzuari Sh. K., pas një marrëveshje telefonike më datë 9 shkurt 2009 me personin me emrin M. N., më datë 10 shkurt 2009 me të pandehurin A. R. tek qendra tregtare Ben Af në Suharekë morën 2 qese me substanca narkotike, tipi heroinë, nga persona PP dhe e vendosën në bagazhin e makinës, Mercedes ML, me targa XX KS XX, e cila është pronë e të pandehurit

Sh. K. dhe pastaj transportuan substancat narkotike në Prizren. I pandehuri tjetër, M. S., përmes numrit të telefonit i cili i ishte siguruar nga M. N., ftoi të pandehurin Sh. K. në Prizren dhe të pandehurit M. S. dhe N. M. u takuan me të në hotelin R. i cili ndodhet në rrugën P. – F. në fshatin C. për të diskutuar shitjen e substancave narkotike. Ata kontaktuan me dy persona PP për të diskutuar shitjen e substancave narkotike. Më datë 13 shkurt 2009, rreth orës 15.00, në afërsi të Ben Af-it në Prizren, dy persona PP kontaktuan të pandehurit M. S. dhe Sh. K., duke pretenduar se ishin të interesuar të blinin narkotikët, ata shkuan së bashku tek makina e lartpërmendur, Mercedes ML. Pasi panë narkotikët, ata u larguan nga makina dhe thirrën dy të pandehurit në fjalë për t'u dhënë të hollat, ndërkohë që gjatë asaj kohe, dy të pandehurit e tjerë, N. M. dhe A. R., ishin duke kontrolluar zonën për të parandaluar që të vëreheshin apo arrestoheshin nga policia. Në atë moment, njëسيا policore mbështetëse ndërhyri dhe arrestoi të pandehurit Sh. K., N. M. dhe M. S., dhe nga makina Mercedes ML, policia sekuestroi substancën narkotike, heroinë përzier me paracetamol dhe kafeinë, me peshë 13.882 kg.

Ky veprim kriminal u cilësua si blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e drogave të rrezikshme dhe substancave psikotrope, në kundërshtim me Nenin 229, par. 4 pika 1, KPK që dënohet me gjobë dhe burgim nga tre deri pesëmbëdhjetë vjet.

- 2) Kundër N. M.: gjatë kontrollit të shtëpisë të të pandehurit N. M. më datë 13 shkurt 2009, u gjet një pistoletë, model Crvena Zastava, kalibri M-57, 7.62 mmX25 mm me numër serik C211115, me karikator me 8 fishekë, pa lejen përkatëse.

Kjo veprë penale u cilësua si posedim, kontroll apo përdorim i paautorizuar i armës, në kundërshtim me Nenin 328 (2), KPP, që dënohet me gjobë deri 7.500 Euros apo me burgim nga një deri tetë vjet.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor, me dyer të hapura për publikun, më datë 12, 17, 18, 19 dhjetor 2013, 24, 29 janar, 10, 24, 27 mars dhe 15 prill 2014 në praninë e:

- Prokurorit të PSRK-së Rexhat Millaku,
- Të akuzuarit Sh. K. dhe avokatit të tij mbrojtës B. T.,
- Të akuzuarit N. M. dhe avokatëve të tij mbrojtës K. K. dhe H. S.,
- Të akuzuarit M. S. dhe avokatit të tij mbrojtës H. K.,
- Të akuzuarit A. R. dhe avokates së tij mbrojtëse H. C.,

Pas shqyrtimit dhe votimit më datë 15 prill 2014, në pajtim me Nenin 471, paragrafi 1, Kodi i Procedurës Penale (më pas “KPP”), më datë 17 prill 2014, shpall publikisht si më poshtë:

### **AKTGJYKIM**

- 1) A. R., N. M. dhe M. S. shpallen jo të fajshëm për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e drogave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrope, në kundërshtim me Nenin 229, par. 4, KPK, veprë me të cilën janë akuzuar, sepse nuk është vërtetuar se kanë kryer veprën për të cilën akuzohen;
- 2) Sh. K. shpallet fajtor për veprën penale posedimi i paautorizuar i drogave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrope, në kundërshtim me Nenin 229, par. 1, KPK sepse është vërtetuar se më datë 13 shkurt 2009, rreth orës 15.00 në parkingun e qendrës tregtare Ben Af, në Prizren, ka poseduar me qëllimin e shitjes apo shpërndarjes së drogës narkotike, heroinë, prej 13.882 kg, e cila ishte në brendësi të makinës së tij Mercedes ML, me targa XX KS XX,

#### **Prandaj:**

Sipas Nenit 229, par. 1, KPK, Sh. K. dënohet për këtë veprë penale me 3 (tre) vjet burgim dhe gjobë në shumën prej 5000 (pesë mijë) euro,

Sipas Nenit 36, paragrafi, 2, KPP, afati për pagesën e gjobës nga Sh. K. përcaktohet në 1 (një) muaj;

Sipas Nenit 73, paragrafi (1) dhe (3), KPK, koha që Sh. K. ka kaluar në paraburgim, nga data 13 shkurt 2009 deri më datë 13 shkurt 2012 llogaritet në dënimin me burgim dhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14 shkurt 2012 deri më datë 21 shkurt 2012 përfshihet në dënimin me gjobë (barabartë me 120 euro);

Sipas Nenit 229, par. 5, KPK, konfiskohet sasia e heroinës prej 13.882 kg;

- 3) Në pajtim me Nenin 389, par. 4, KPPK, hidhet poshtë akuza pronësia, posedimi, kontrolli apo përdorimi i paautorizuar i armëve, në kundërshtim me Nenin 328 (2), KPK, kundër N. M., sepse Ligji mbi Amnistinë e mbulon këtë veprë në kohën përmendur në aktakuzë;

- 4) Sipas Nenit 489, par. 1, KPPK, konfiskohet pistoleta, model Crvena Zastava, kalibër M-57, 7.62mm X 25mm me numër serik C211115, me karikator me 8 fishekë.
- 5) Sipas Nenit 451, paragrafi 4, KPPK, shpenzimet e procedurës penale paguhet pjesërisht nga i akuzuari Sh. K. në shumën prej 1000 (një mijë) euro.
- 6) Pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës penale paguhet nga buxheti.

## **ARSYETIMI**

### ***E kaluara procedurale***

#### *Aktakuza*

- 1) Më datë 7 gusht 2009, PSRK-ja ushtroi aktakuzën PPS 03/09 e cila u ndryshua në bazë të aktvendimit për konfirmim, datë 24 shtator 2009, kundër të pandehurve Sh. K., N. M. dhe M. S. akuzuar me *Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e drogave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrope* (Neni 229, par. 4 pika 1, KPK), që dënohet me gjobë dhe burgim nga tre deri pesëmbëdhjetë vjet. Për më tepër, N. M. u akuzua për veprën penale *pronësi, kontroll apo përdorim i paautorizuar të armëve* (Neni 328 par.2, KPK), që dënohet me gjobë deri 7.500 euro ose burgim nga një deri tetë vjet.
- 2) Më datë 30 shtator 2009, PSRK-ja ushtroi aktakuzë kundër A. R., duke e akuzuar për *Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e drogave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotrope* (Neni 229, par. 4 pika 1, KPK).
- 3) Më datë 30 tetor 2009, sipas Nenit 33, KPPK, Gjykata urdhëroi bashkimin e dy aktakuzave gjykimin e përbashkët të të pandehurve.
- 4) Shqyrtimi i parë kryesor kundër të pandehurve filloi më datë 20 tetor 2009 dhe në atë kohë Gjykata Qarkut në Prizren shpalli aktgjykimin më datë 09 shkurt 2010 duke gjetur të katër të pandehurit fajtorë për veprat penale me të cilat akuzoheshin dhe i dënoi ata si në vijim: Sh. K. me 8 vjet burgim dhe 5000 euro gjobë, N. M. 8 vjet dhe 3 muaj burgim dhe 5000 euro gjobë, M. S. me 6 vjet burgim dhe 5000 euro gjobë dhe A. R. 8 vjet burgim dhe 5000 euro gjobë.

- 5) Duke vepruar në bazë të ankesave ushtruar nga Mbrojtja kundër aktgjykimit, Gjykata Supreme e Kosovës nxori vendim më datë 26 korrik 2011 duke pranuar ankesat dhe si pasojë anuloi Aktgjykimin e datës 09 shkurt 2010 dhe ktheu lëndën për ri-gjykim në gjykatën e shkallës së parë.
- 6) Shqyrtimi i dytë kryesor filloi më datë 20 shkurt 2012. Më datë 23 maj 2012, gjykata vendosi të hedhë poshtë të gjitha akuzat ndjekja penale është e ndaluar sipas Nenit 389, par.4 KPPK. Të pandehurit ishin liruar nga paraburgimi që nga data 21 shkurt 2012.
- 7) Më datë 28 maj 2013, Gjykata e Apelit nxorri vendim duke aprovuar ankesën e datës 0 korrik 2012 parashtruar nga Prokurori më datë 06 korrik 2012 dhe anuloi Aktgjykimin e, në atë kohë, Gjykatës së Qarkut Prizren, datë 23 maj 2012 dhe ktheu lëndën për ri-gjykim për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës penale, përcaktimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal. Më tej, Gjykata e Apelit udhëzoi Gjykatën Themelore që t'i referohej çështjes së pranueshmërisë së provave në bazë të informacionit siguruar me anë të raportit të datës 19 mars 2012 dhe se kjo gjykatë duhet të zhvillojë shqyrtimin kryesor në bazë të ligjit. Për më tepër, Trupi Gjykues duhet të përcaktojë, para fillimit të shqyrtimit kryesor, nëse ndonjë nga të akuzuarit ka nevojë për përkthim në gjuhën turke.
- 8) Shqyrtimi kryesor kundër katër të akuzuarve filloi më datë 12 dhjetor 2013. Të gjithë të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm. Gjatë shqyrtimit kryesor të gjithë të pandehurit, me përjashtim të A. R., vendosën të qëndrojnë në heshtje.
- 9) Më datë 20 mars 2014, prokurori parashtrroi ndryshim të aktkuzës duke shtuar në dispozitivin e aktakuzës përshkrimin e aktiviteteve inkriminuese.

#### *Ligji procedural i aplikueshëm*

- 10) Meqenëse gjatë procedurës penale kundër të akuzuarve ligji procedural pësoi ndryshime thelbësore, është e nevojshme të bëhet një përmbledhje e shkurtër e ligjit të aplikueshëm, si çështje paraprake, para diskutimit mbi meritat e lëndës.
- 11) Me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale (më tej "KPP"), Ligji 04/L-123 i vitit 2012 që nga data 1 janar 2013, ligji procedural ndryshoi thelbësisht. Ndërkohë që në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të UNMIK-ut 2004 (më tej "KPPK") procedura ishte më e orientuar drejt ligjit kontinental, kodi i ri prezantoi një procedurë me palë kundërshtare.

Për çështjen në fjalë, pyetjet më të rëndësishme që shtrohen lidhur me ligjin e aplikueshëm është nëse procedura në Gjykatë do të udhëhiqet nga KPP apo nga KPPK. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohet se cilat dispozita duhet të aplikohen nga Gjykata për vlerësimin e pranueshmërisë së provave të mbledhura gjatë hetimit i cili është zhvilluar sipas kodit të mëparshëm. Në mënyrë që t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve është e domosdoshme që t'u referohemi dispozitave kalimtare të Kapitullit XXXVIII, KPP.

12) Neni 544, KPP, parasheh si në vijim:

*“Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi paraqitet ankesë ose me mjet të jashtëzakonshëm juridik anulohet aktgjykimi, shqyrtimi gjyqësor zbatohet përshtatshëm sipas dispozitave të kodit të mëparshëm.”*

13) Në lëndën në fjalë aktakuzat kundër të gjithë të akuzuarve u ushtruan në vitin 2009, kohë gjatë së cilës KPPK ishte ligji i aplikueshëm. Dy aktgjykimet e para shpallur në këtë lëndë janë anuluar nga Gjykata e Apelit dhe lënda u kthye për ri-gjykim në gjykatën e shkallës së parë. Sipas dispozitës së cituar më lart, shqyrtimi kryesor është zhvilluar sipas kodit të mëparshëm.

*Kompetenca e Gjykatës dhe Përbërja e trupit Gjyqësor:*

14) Në pajtim me Nenin 11 (1) *Ligji mbi Gjykatat (Ligji Nr. 03/L-199)* Gjykata Themelore është kompetente për të gjykuar të gjitha lëndët në shkallë të parë, përveç rasteve kur në ligj parashihet ndryshe.

15) Sipas Aktakuzës, veprat penale janë kryer në qytetin e Prizrenit në territorin e Gjykatës Themelore Prizren. Për këtë arsye, në pajtim me Nenin 27 (1) KPPK, kjo gjykatë ka jurisdiksion territorial për gjykimin e kësaj lënde.

16) Lidhur me përbërjen e trupit gjyqësor palët nuk shprehën asnjë vërejtje.

*Kompetenca e Prokurorit për Ndryshimin e Aktakuzës*

17) Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, mbajtur më datë 27 mars 2014, Prokurori i PSRK-së parashitri ndryshimin e aktakuzës kundër të gjithë të akuzuarve ku ai mbajti një dispozitiv kundër të gjithëve lidhur me veprën penale të posedimit dhe shpërndarjes së drogës dhe

substancave narkotike. Sipas kërrij ndryshimi, Sh. K., M. S., A. R. dhe N. M. u akuzuan për veprat penale siç janë shënuar në dispozitivin e aktgjykimit.

18) Në bazë të kërkesës së Kryetarit të Trupit Gjykses, Prokurori spjegoi se baza ligjore për ndryshimin e aktakuzës është bërë sipas Nenit 376 (1) KPPK, ku parashihet:

*“Kur paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund të ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re.”*

19) Në pajtim me Nenin 376 (3) KPPK, Mbrojtjes iu dha mundësia të parashtrijë një kërkesë për ndërprerjen e shqyrtimit kryesor me qëllim që të përgatisë mbrojtjen. Askush nuk kërkoi pushimin e procedurës.

20) Gjatë seancës, mbrojtja e A. R. paraqiti qëndrimin e saj lidhur me këtë çështje. Mbrojtja ishte e mendimit se Prokurori nuk mund të lejohej të ndryshonte aktakuzën sepse kjo bazohej në prova të papranueshme.

21) Trupi Gjykses konstatoi se Prokurori ishte i autorizuar të ndryshojë aktakuzën në këtë fazë të procedurës, në pajtim me dispozitat relevante të lartpërmendura të KPPK-së.

#### *Shqyrtimi Kryesor*

22) Shqyrtimi kryesor u zhvillua me dyer të hapura për publikun më datë 12, 17, 18, 19 dhjetor 2013, 24, 29 janar 2014, 10, 24, 27 mars 2014 dhe 15 prill 2014 në praninë e Prokurorit të PSRK-së, Rexhat Millaku, të akuzuarit Sh. K. dhe avokatit të tij mbrojtës B. T., të akuzuarit N. M. dhe avokatëve të tij mbrojtës K. K. dhe H. S., të akuzuarit M. S. dhe avokatit të tij mbrojtës H. K. dhe të akuzuarit A. R. dhe avokatit të tij mbrojtës H. C..

23) Në pajtim me ligjin procedura gjyqsore dhe të gjitha dokumentet relevante të gjykatës u përkthyen nga gjuha angleze në atë shqipe dhe anasjelltas nga përkthyes ndërkombëtarë. Për të akuzuarit Sh. K. dhe N. M. u sigurua gjithashtu edhe përkthim në gjuhën turke.

## ***Gjetjet faktike***

- 24) Gjatë, të paktën, 10 ditë para datës 13 shkurt 2009, zyrtarë të Departamentit Special për Krime Narkotike të Policisë në Prishtinë kanë kryer një operacion të fshehtë të simulimit të blerjes së drogës<sup>1</sup>. Kjo masë e fshehtë nuk është autorizuar nga urdhër i gjykatësit të procedurës paraprake.
- 25) Në mëngjesin e datës 13 shkurt 2009, policia në Prishtina siguroi informata nga shërbimi i zbulimit Prizren, në zonën rreth qendrës tregtare Ben Af do të tentohej të shitej drogë. Zyrtarët e policisë të përfshirë në këtë operacion ishin të informuar mbi tipet e makinave që do të përdoreheshin nga kryerësit e dyshuar, mes të cilëve ishin Mercedes ML, Golf V dhe Audi A3. Në këtë fazë të operacionit ata nuk kishin siguruar informata lidhur me personat që dyshoheshin se do të ofronin drogë.<sup>2</sup>
- 26) Anëtarët e njësisë speciale përgjegjëse për luftimin e drogës, vëzhgimit dhe ato të njësive mbështetëse arritën në Prizren, në parkingun e Ben Af parking rreth orës 12.00. Ata u vendosën në vende të ndryshme në zonë dhe po vëzhgonin makinat që vinin aty. Për të komunikuar me njëri tjetrin zyrtarët e policisë përdorën radio dhe telefonë celularë. A. O. ishte përgjegjës për këtë operacion.<sup>3</sup>
- 27) Rreth orës 14.00 u panë makinat Audi A3 dhe Mercedes ML i zi që po afroheshin tek Ben Af, të cilat përputheshin me përshkrimin e dhënë zyrtarëve në mëngjes. Audi A3 u parkua në parking kurse Mercedes ML në rrugë, në krah të hyrjes. Pasi pak kohësh aty erdhi Golf V i cili parkoi pas Mercedesit. Më pas doli se Sh. K. ishte shoferi i Mercedesit dhe N. M. shoferi i Golfit.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Dëshmitë e dëshmitarit 25, procesverbali i datës 29 janar 2014, fq. 4 – 25; dëshmitë e A. O., procesverbali i datës 10 mars 2014, fq. 3 - 13

<sup>2</sup> Dëshmitë e F. R., procesverbali i datës 12 dhjetor 2013, p. 10 – 23; dëshmitë e një dëshmitari 0110, procesverbali i datës 17 dhjetor 2013, fq. 2 – 22;

<sup>3</sup> Dëshmitë e F. R., procesverbali i datës 12 dhjetor 2013, fq. 10 – 23; Dëshmitë e A. O., procesverbali dhjetorit 2013, fq. 25 – 41; Dëshmitë e dëshmitarit 0110, procesverbali i datës 17 dhjetor 2013, fq. 2 – 22; Dëshmitë e dëshmitarit 1811, procesverbali i datës 17 dhjetor 2013, fq. 23 - 35; Dëshmitë e dëshmitarit 2002, procesverbali i datës 24 janar 2014, fq. 3 – 11;

<sup>4</sup> Dëshmitë e F. R., procesverbali i datës 12 dhjetor 2013, fq. 10 – 23; Dëshmitë e A. O., procesverbali i datës 2013, fq. 25 – 41; Dëshmitë e dëshmitarit 0110, procesverbali i datës 17 dhjetor 2013, fq. 2 – 22; Dëshmitë e dëshmitarit 2002, procesverbali i datës 24 janar 2014, fq. 3 – 11;

- 28) N. M. doli nga makina e tij dhe hyri në Mercedes ku ndenji për pak kohë, duke biseduar me Sh. K.. Më pas ai u largua dhe shkoi në një dyqan përpunimi druri.<sup>5</sup> Atje ai bisedoi me pronarin e dyqanit F. M. lidhur me parketin që donte të blinte.<sup>6</sup>
- 29) Rreth orës 15.00 dy agjentë të fshehtë (përfshirë dëshmitarin 25) u takuan me Sh. K. i cili ishte shoferi i Mercedes ML. Gjatë pjesës tjetër të bisedës e cila u zhvillua brenda makinës mes Sh. K. dhe dëshmitarit 25, ky i fundit u informua se K. kishte me vete rreth 14 kg heroinë. K. ia kishte treguar qesen me të agjentit i cili e kishte testuar nëse ishte substanca siç ishte deklaruar nga i akuzuari. Kur ai vërtetoi natyrën e përmbajtjes, dëshmitari 25 dhe Sh. K. dolën nga Mercedesi dhe shkuan në makinën përdorur nga agjentët për të finalizuar shkëmbimin. Gjatë rrugës dëshmitari 25 u bëri shenjë zyrtarëve të policisë nga njësia mbështetëse për të arrestuar Sh. K. dhe kryerësit e tjerë të pretenduar të shitjes së drogës.<sup>7</sup>
- 30) Gjatë operacionit zhvilluar në parkingun e Ben Af-it në Prizren policia arrestoi Sh. K. dhe disa persona të tjerë, përfshirë N. M., M. S. dhe A. R.. Të gjithë u dërguan në stacionin e policisë ku u morën në pyetje lidhur me pjesëmarrjen e pretenduar në posedimin, blerjen dhe shpërndarjen e drogës dhe substancave të tjera narkotike.<sup>8</sup>
- 31) Substanca e konfiskuar në makinën e Sh. K. u ekzaminua nga ekspertët. Ata gjetën se peshonte 13.882 kg dhe se përbëhej nga të paktën 50 % heroinë.<sup>9</sup>
- 32) Të njëjtën ditë, pasi përfundimit të operacionit tek parkingu i Ben Af-it, policia zhvilloi një kontroll në shtëpinë e N. M.. Si rezultat i kësaj u gjetën një pistoletë Crvena Zastava, kalibër M-57, 7.62 mm X 25 mm me numër serik C211115, me karikator i cili përmbante 8 fishekë që i takonte N. M.. Ai nuk posedonte leje të vlefshme për posedimin e këtyre pajisjeve.<sup>10</sup>

---

<sup>5</sup> Dëshmitë e F. R., procesverbali i datës 12 dhjetor 2013, fq. 10 - 23

<sup>6</sup> Dëshmitë e F.M., procesverbali i datës 18 dhjetor 2013, fq. 2 - 16

<sup>7</sup> Dëshmitë e dëshmitarit 25, procesverbali i datës 29 janar 2014, fq. 4 – 25

<sup>8</sup> Dëshmitë e F. R., procesverbali i datës 12 dhjetor 2013, fq. 10 – 23; <sup>8</sup> Dëshmitë e A. O., procesverbali i datës dhjetor 2013, fq. 25 – 41; <sup>8</sup> Dëshmitë e F. M., procesverbali i datës 18 dhjetor 2013, fq. 2 - 16

<sup>9</sup> Opinioni i ekspertit S. D., procesverbali i datës 19 dhjetor 2013, p. 2 – 10; raporti toksikologjik nr 2009/0408 datë 27 prill 2009; Raporti shtesë datë 26 tetor 2009

<sup>10</sup> Vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve datë 13 shkurt 2009; Tetë fotografi më datë 13 shkurt 2009 nga sendet e konfiskuara në shtëpinë e N. M.

## ***Vlerësimi i provave***

### *Vërejtje të përgjithshme*

- 33) Trupi Gjykses gjen se është e nevojshme të theksohet fakti se shumica e provave kundër të akuzuarve, në bazë të së cilave Prokurori mbështeti aktakuzën Trial Panel, u mblodhën si rezultat i masës së fshehtë zhvilluar nga ana e policisë. Këto aktivitete operacionale u zhvilluan para fillimit zyrtar të hetimeve dhe përbëheshin nga një operacion i fshehtë përfshirë blerjen e simuluar të sendeve. Siç rezulton nga informatat e siguruar gjatë shqyrtimit kryesor agjentët sekretë që kanë vepruar në këtë lëndë kanë provokuar.
- 34) Operacione të kësaj natyre mund të aplikohen vetën në raste përjashtimore, kur ekzistojnë rrethana të cilat parashihen në mënyrë rigoroze nga ana e ligjit. Kushti i domosdoshëm për të bazuar një aktgjykim në prova të cilat janë siguruar përmes veprimeve të tilla është zbatimi i të gjitha kushteve ligjore nga ana e zyrtarëve të policisë dhe prokurorit të cilët zhvillojnë operacionin. Të gjitha operacionet duhet të zhvillohen duke respektuar ligjin dhe gjykata është e detyruar që të vlerësojë në mënyrë rigoroze dhe të plotë ligjshmërinë dhe pranueshmërinë e provave të siguruar përmes tyre. Një qasje e tillë parandalon policinë dhe institucione të tjera shtetërore që të abuzojnë me kompetencat e tyre lidhur me një individ të caktuar dhe është element i nevojshëm në sundimin e ligjit dhe të drejtën për një gjykim të drejtë.
- 35) Në parim, në fazën kur aplikohet një masë e fshehtë para fillimit të hetimeve, qasja që gjykata ka në materialet e siguruar përmes një masë e tillë është shumë e kufizuar. Kjo do të thotë se vlerësimi i këtij veprimi të aktivitetit të policisë mund të bëhet vetëm kur ushtrohet aktakuza. Në këtë moment gjykata ekzaminon nëse provat e siguruar në pajtim me rregullat e parapara në kodin e procedurës penale, dhe si të tilla janë të ligjshme, apo të shohë nëse ka qenë një operacion i paligjshëm. Provat e siguruar të cilat nuk përmbushin kushtet rigoroze ligjore duhet të trajtohen si prova të siguruar në mënyrë të paligjshme dhe për këtë arsye si të papranueshme.
- 36) Masat e fshehta ndërhyjnë *per se* në mënyrë drastike në të drejtën kushtetuese për privatësinë, liri dhe fshehtësi komunikimi dhe si të tilla janë në konflikt me garancinë kushtetuese të mbrojtjes nga ana e gjykatës të të drejtave të njeriut. Për këtë arsye,

përdorimi i tyre nga institucionet shtetërore kërkon profesionalizëm dhe zbatim rigoroz të kushteve ligjorë.

*Vlerësimi i provave në lëndën në fjalë*

- 37) Trupi Gjykues thekson se procedura e provave në këtë lëndë përmban shumë shkelje të ligjit të procedurës të cilat janë bërë gjatë zhvillimit të hetimeve dhe para fillimit zyrtar të hetimeve. Për më tepër, ka pasur një mungesë të dukshme bashkëveprimi mes prokurorit dhe zyrtarëve të policisë që kanë marrë pjesë në procedurën penale gjë e cila ka patur ndikim negativ në rezultatet e hetimeve.
- 38) Nuk ka dyshim se para datës 13 shkurt 2009 u zhvillua një operacion i fshehtë i cili kishte ëpr qëllim zbulimin e personave përfshirë në shpërndarjen e drogës. Zyrtarët e policisë zhvilluan një aksion të blerjes së simuluar të drogës. Ky fakt mbështetet edhe nga provat e administruara gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor, në veçanti dëshmitë e dëshmitarit A. O. dhe dëshmitarit 25.
- 39) Prokurori nuk ishte në gjendje që të paraqiste në gjykatë urdhrat e lëshuar nga gjykatësi i procedurës paraprake i cili do të kishte autorizuar policinë që të zhvillonte këtë lloj operacioni. U vetmi dokument lidhur me aktivitetet e policisë para datës 13 shkurt 2009 u sigurua nga shqyrtimi kryesor nga dëshmitari A. O.<sup>11</sup> Ky është një urdhër i prokurorit, datë 12 shkurt 2009, përmes të cilës është autorizuar përgjimi i telefonit të N.M. Nga ky dokument nuk është shumë e qartë se në cilën procedurë penale është nxjerrë, sepse urdhri i referohet një aktvendimi të mëparshëm lidhur me vazhdimin e masave të fshehta.
- 40) Trupi Gjykues nuk pajtohet me prokurorin se në këtë situatë urdhri i gjykatës nuk ishte i nevojshëm dhe se zyrtarët e policisë ishin të autorizuar të zhvillonin një operacion kundër personave të cilët pretendohen se ishin përfshirë në shpërndarjen e drogës dhe substancave narkotike.
- 41) Termi i përdorur “blerja e simuluar e një sendi” përcaktohet në Nenin 256 (7), KPPK, sipas të cilit një masë e tillë e fshehtë nënkupton aktin e blerjes nga një person, i cili dyshohet se ka kryer një vepër penale, i një sendi i cili mund të shërbejë si provë në procedurën penale. Në përputhje me Nenin 258 (2.8) KPPK blerja e simuluar ka si kusht urdhrin e lëshuar nga

---

<sup>11</sup> Parashtruar në gjykatë më datë 12 mars 2014

gjykatësi i procedurës paraprake nxjerrë në bazë të kërkesës së prokurorit publik. Siç rezulton nga Neni 257 (3.1.i) KPPK (neni relevant në këtë lëndë) blerja e simuluar mund të urdhërohet kundër një personi të caktuar nëse ekziston dyshimi i bazuar se ky person ka kryer, apo në rastet kur tentativa dënohet, ka tentuar të kryejë një veprë penale që dënohet me të paktën katër vjet burgim. Për më tepër, në pajtim me Nenin (3.2) KPPK informata e cila mund të sigurohet nga masa e cila kërkohet ka gjasa të ndihmojë në hetimet e veprës penale dhe se nuk ka gjasa që kjo të sigurohet përmes veprimeve të tjera hetimore pa vështirësi të paarsyeshme apo rrezik potencial për të tjerët.

- 42) Prokurori mbajti qëndrimin se përcaktimi i blerjes së simuluar i referohet vetëm momentit të blerjes, gjë e cila sipas mendimit të tij duhet të kufizohet në aktin e këmbimit të mallrave për para. Në këtë lëndë kjo nuk ka ndodhur sepse blerja nuk është realizuar sepse nuk është përfunduar këmbimi. Për këtë arsye Prokurori është i mendimit se urdhri i gjykatës nuk kërkohet nga ligji.
- 43) Trupi Gjykoës nuk pajtohet me një interpretim të tillë të masës së fshehtë. Termi “blerje e simuluar” përshin të gjitha veprimet e ndërmarra nga hetuesit e policisë në mënyrë të drejtpërdrejtë me qëllimin për të blerë një send, që do të thotë këmbimi i mallrave për para me qëllimin e sigurimit të pronës. Para këtij momenti zhvillohet kontakti me blerësit potencialë (të drogës në këtë lëndë), negociatat për çmimin, sasinë dhe cilësinë që do të dorëzohen.
- 44) Analiza e provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor va çon në përfundimin se të paktën 10 ditë para ngjarjes që ndodhi në parkingun e Ben Af-it në Prizren u zhvillua një operacion i fshehtë të blerjes së simuluar të drogës. Agjentë të fshehtë kishin takuar disa herë furnizues potencialë të substancës narkotike dhe ata kishin negociuar me ta për kushtet e blerjes (sasinë, cilësinë dhe çmimin), ata kishin siguruar masën financiare nga burime Operacionale për të përmbyllur këtë transaksion dhe ata ishin pajtuar lidhur me datën dhe vendin e shkëmbimit. Në ditën e përcaktuar të blerjes, njësi të tjera policore ishin informuar mbi operacionin dhe ishin përfshirë në të. Aty u bë edhe takimi me furnizuesin e drogës (Sh. K.), i cili tregoi narkotikët. Në këtë moment u bë ndërprerja e operacionit dhe kryerësit e pretenduar të shitjes së drogës u arrestuan.
- 45) Siç është përmendur më lart, kjo blerje e simuluar e drogës është zhvilluar para fillimit zyrtar të hetimeve kundër të akuzuarve në këtë lëndë. Për më tepër, Prokurori nuk kishte

siguruar urdhër të gjykatës për këtë operacion. Për këtë arsye, në pajtim me Nenin 264 (1) KPPK, që interpretohet *a minori ad maius*, prova e siguruar nga masa e blerjes së simuluar është provë e papranueshme.

- 46) Për këtë arsye, relevanca e dëshmive të dëshmitarëve ekzaminuar gjatë shqyrtimit kryesor (A. O., F. R., dëshmitarët 0110, 25, 2002 dhe 1811) kufizohet vetëm në konstatimin se më datë 13 shkurt 2009 i akuzuari Sh. K. ka patur në posedim substancë narkotike. Këto prova nuk mund të përdoren kundër të akuzuarve për të vërtetuar përfshirjen e pretenduar të tyre në shpërndarjen apo shitjen e drogës para asaj date sepse dëshmitarët kanë përshtetur veprime të cilat sipas mendimit të Trupit Gjykes janë të paligjshme.
- 47) Për më tepër, Trupi Gjykes është i mendimit se ishte e nevojshme që të merreshin në pyetje në cilësinë e dëshmitarëve zyrtarët e policisë të cilët kanë marrë pjesë në operacionin para ditës kritike sepse ishte shumë e rëndësishme të zbulohet se çfarë lloj operacioni ishte zhvilluar kundër të akuzuarve. Ky detyrim rezulton gjithashtu nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, datë 28 maj 2013.
- 48) Gjatë operacionit zhvilluar më datë 13 shkurt 2009 në parkingun e Ben Af në Prizren zyrtarët e policisë kanë zbatuar masën e fshehtë të fotografimit dhe vëzhgimit me video në vende publike. Ata kanë monitoruar, observuar dhe incizuar persona të cilët pretendohen se kanë qenë të përfshirë në shpërndarjen e drogës, përmes fotografimit dhe video, pa dijeninë apo lejen e tyre.
- 49) Gjatë kohës së operacionit zyrtarët e policisë nuk kishin urdhër me shkrim nga prokurori për masën e fshehtë të fotografimit dhe vëzhgimit me video në vende publike. Urdhri u lëshua në mënyrë retroaktive nga prokurori më datë 15 shkurt 2009.
- 50) Trupi Gjykes gjen se ky urdhër nuk është dashur të konfirmohet nga gjykatësi i procedurës paraprake sepse siç parashihet nga Neni 258, par.1 KPPK masa e fshehtë e fotografimit dhe vëzhgimit me video në vende publike ishte kompetencë e Prokurorit Publik nën autoritetin e tij. Megjithatë, në pajtim me Nenin 259 KPPK urdhri për masën e fshehtë duhet të nxirret me shkrim dhe të specifikojë si në vijim:
- Emrin dhe adresën e objektit apo objekteve të urdhrit,
  - Natyra e masës,
  - Bazat e urdhrit,

- Periudhën kohore gjatë së cilës urdhri është në fuqi, e cila nuk është më shumë se 60 ditë nga data e lëshimit të urdhrit,
- Institucioni i policisë gjyqësore që ka autorizim të zbatojë masën dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të masës.

- 51) Urdhri lëshuar nga prokurori më datë 15 shkurt 2009 nuk përmbush kushtet paraparë nga ligji. Aty nuk janë përmendur emrat e të pandehurve, megjithëse identiteti i tyre njihej nga policia. Për më tepër, bazat për nxjerrjen e një urdhri të tillë, siç parashihen në nenin 257, KPP nuk janë specifikuar. Për këtë arsye, Trupi Gjygues gjen se urdhri i kësaj date për fotografimin e fshehtë dhe vëzhgimin me video në vende publike nuk përmbush kushtet ligjore paraparë nga Neni 259, KPK. Për këtë arsye, provat e siguruar nga kjo masë janë të papranueshme sipas nenit 264 KPP<sup>12</sup>.
- 52) Për më tepër, është e rëndësishme të përmendet se Kodi nuk parasheh nxjerrjen e një urdhri për masa të fshehta nga prokurori në mënyrë retroaktive. Një mundësi e tillë aplikohet vetëm kur prokurori në raste urgjente lëshon një urdhër i cili është kompetencë e gjykatësit të procedurës paraprake, gjë e cila rezulton nga Neni 258 (4) KPPK. Pastaj gjykatësi i procedurës paraprake, brenda njëzet e katër orësh nga data e nxjerrjes së urdhrit, nxjerr urdhër me shkrim duke konfirmuar urdhrin e prokurorit. Nëse ai/ajo dështon të bëjë diçka të tillë atëherë urdhri nuk do të ketë efekt.
- 53) Për këtë arsye, Trupi Gjygues me anë të aktvendimit të datës 19 dhjetor 2013 vendosi që regjistrimet me video dhe fotografitë e siguruar përmes masës së fotografimit të fshehtë dhe vëzhgimit me video, si dhe raportet e përpiluara lidhur me këto të shpallen të papranueshme (“memorandum zyrtar”) datë 13 shkurt 2009, raporti i policisë i datës 16 shkurt 2009 dhe raporti informativ 29 shtator 2009).
- 54) Trupi Gjygues gjen të nevojshme të theksojë se papranueshmëria e provave siguruar përmes vëzhgimit fotografik dhe me video nuk përjashton mundësinë që zyrtarët e policisë që kanë qenë të pranishëm në vendin ku është aplikuar masa e fshehtë të merren në pyete në cilësinë e dëshmitarëve. Ata kanë pasur mundësi të vëzhgojnë situatën, atë që ka qenë duke ndodhur, personat në vendngjarje, etj. Dëshmitë e tyre nuk bien brenda kufijve të provave siguruar përmes vëzhgimit fotografik dhe me video sepse si të tilla trajtohen vetën

<sup>12</sup> Aktvendimi mbi pranueshmërinë e provave, datë 19 dhjetor 2013, fq. 18 – 19 i procesverbalit

fotografitë, regjistrimet me video, raportet si dhe materialet e tjera të cilat janë përpiluar në bazë të tyre.

55) Siç është përmendur më parë, hetimet kundër të akuzuarve kanë filluar zyrtarisht pas operacionit të zhvilluar në parkingun e Ben Af-it në Prizren. Prandaj, Trupi Gjykses është i mendimit se është e nevojshme që të bëhet vlerësimi i këtyre aktiviteteve sipas dispozitave të aplikueshme në këtë fazë, në veçanti dispozitën e Neni 201 KPPK.

56) Neni 200 (1) KPPK parasheh:

*Policia heton veprat penale dhe pa vonesë ndërmerr të gjitha masat në mënyrë që të parandalohet fshehja e provave.*

Neni 201 KPK përcakton si në vijim:

(1)

*Kur ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer një veprë penale që ndiqet sipas detyrës, policia detyrohet qoftë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit publik, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të gjejë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale.*

(2)

*Për të kryer detyrat nga paragrafi 1 i këtij neni policia ka autorizim:*

*1) Të mbledhë informacion nga personat;*

*2) Të kryejë kontroll të përkohshëm të automjeteve, të udhëtarëve dhe të valixheve të tyre;*

*3) Të kufizojë lëvizjen ndaj një vendi të caktuar për kohën gjatë së cilës ky veprim është urgjentisht i nevojshëm;*

*4) Të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përcaktuar identitetin e personave dhe gjësendeve;*

*5) Të organizojë një bastisje për të gjetur personin apo gjësendin e kërkuar duke dërguar një qarkore për bastisje;*

*6) Të bastisë ndërtesa dhe godina të caktuara të subjekteve publike në prani të një personi përgjegjës dhe të shqyrtojë dokumentacion e caktuar që u përket atyre;*

7) Të konfiskojë gjësende që duhen konfiskuar sipas Kodit të Përkohshëm Penal apo të cilat mund të shërbejnë si prova në procedurë penale;

8) Të ofrojë ekzaminim fizik palës së dëmtuar në pajtim me nenin 192 të kodit aktual dhe

9) Të ndër marrë hapat dhe veprimet e nevojshme të parapara me ligj.

57) Interpretimi i këtyre dispozitave, përfshirë edhe atë sistematike sjellë deri te përfundimi se kemi të bëjmë me veprimet e policisë para se të fillojë formalisht hetimi. Mbi këtë bazë, gjatë fazës “para hetimore”, policia është e autorizuar të ndër marrë aktivitete të posaçme, përfshirë edhe mbledhjen e provave. Kompetenca e tillë për të vepruar para se të fillojë hetimi formalisht është e nevojshme për të luftuar krimin në mënyrë efikase.

58) Trupi Gjykses pohon se veprimet e ndër marra nga policia më 13 shkurt 2009 në parkingun e Ben Af-it në Prizren duhen vlerësuar në pajtim me dispozitat e cekura më lart. Është e qartë se policia ka pranuar informata të inteligjencës lidhur me blerjen e pretenduar të drogës. Për këto arsye, Trupi Gjykses beson se ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një vepër penale që ndiqet *ex officio* dhe policia kishte obligim ligjor të veprojë drejt gjetjes së kryerësit në mënyrë që të ruajë të gjitha gjurmët dhe provat. Për këtë qëllim, mbi të gjitha, ishte e nevojshme të kryhet inspektimi i përkohshëm i veturës, të përcaktohet identiteti i personave dhe gjësendeve dhe të konfiskohen gjësendet që duhen konfiskuar sipas Kodit dhe që mund të shërbejnë si prova në procedurë penale.

59) Më 13 shkurt 2009, pas pranimit të informatës lidhur me shitjen eventuale të drogës, policia ndër morri veprime për të gjetur kryerësit e pretenduar dhe për të ruajtur provat. Për pasojë, është arrestuar Sh. K. duke poseduar në veturën e tij substancë narkotike. Kjo gjetje faktike bazohet kryesisht mbi dëshmitë e dëshmitarëve të marrë në pyetje gjatë shqyrtimit kryesor dhe këta janë A. O., F. R. dhe dëshmitarët e mbrojtur 25, 2002, 1811 dhe 0110.

60) Që të gjithë dëshmitarët kanë bërë një raportim të logjikshëm dhe të detalizuar mbi vrojtimitet e bëra nga secili në kohën kritike. Dëshmitë e tyre janë pasuese dhe përputhen me njëra-tjetrën. Trupi Gjykses ka përqëndruar vëmendjen posaçërisht te dëshmia e dëshmitarit 25, i cili kishte qenë i pranishëm në veturë derisa Sh. K. i tregoi atij substancën narkotike. Ai përshkroi detalisht se çfarë po ndodhte brenda në veturë dhe pasi që u larguan nga ajo. Ai njohu Sh. K. si personin që kishte në posedim narkotikët dhe që i tregoi atij ato brenda veturës Mercedes ML.

- 61) Gjatë shqyrtimit kryesor, në seancën e datës 19 dhjetor 2012, janë prezantuar dy DVD-ja. Këto prova janë të pranueshme sepse siç është përcaktuar, këto nuk janë bërë nga vëzhgimi me video i kryer nga ana e policisë, por ishin nga Qendra Tregtare Ben Af. Këto ishin të dhëna nga kamerat industriale të vëna nga pronari i qendrës në hapësirën e tij private. Relevanca e tyre në këtë lëndë nuk është aq e lart ngase këto materiale konfirmojnë vetëm praninë e zyrtarëve të policisë në parkingun e Ben Af-it në Prizren dhe arrestimin e disa personave.
- 62) Pas krahasimit të detalizuar reciprok në mes të dëshmive të dhëna nga A. O., F. R. dhe dëshmitarëve të mbrojtur 25, 2002, 1811 dhe 0110 si dhe provave të tjera të mbetura që u theksuan më lart, Trupi Gjykses erdhi deri te përfundimi se sa u përket elementeve esenciale, që të gjitha këto prova plotësisht përputhen dhe konfirmojnë njëra-tjetrën. Kisha ca mospërputhje dhe ndryshime të vogla në mes të dëshmive të dëshmitarëve si për shembull vendodhja e saktë e veturave të shfrytëzuara nga kryerësit e pretenduar. Mirëpo, mendimi i Trupit Gjykses është se këto ishin pasojë e kalimit të kohës dhe e papërsosurisë së natyrshme të kujtesës së qenies njerëzore. Ç'është e vërteta, këto mospërputhje kanë bindur Trupin Gjykses se dëshmitë ishin krejtësisht spontane dhe se nuk janë sajuar paraprakisht nga dëshmitarët.
- 63) Trupi Gjykses gjen se raporti toksikologjik nr. 2009/0408 i datës 27 prill 2009, raporti shtesë i datës 26 tetor 2009 dhe mendimi verbal i ekspertit S. D. janë prova të besueshme. S. D. ka ekspertizë të duhur dhe përvojë profesionale në ekzaminimin e substancave narkotike. Ai në mënyrë të plotë sqaroi mënyrën se si kreu analizën, metodat që përdori dhe përfundimet të cilat erdhi. Përpos kësaj, S. D. qartësoi se pse nuk ishte e mundur të përcaktohej sasia e saktë e heroinës në substancën që është konfiskuar. Sidoqoftë, mendimi i tij prej eksperti në mënyrë të qartë sjellë deri te përfundimi se substanca përmbante të paktën 50 % heroinë. Trupi Gjykses gjen se kjo mjafton për të përcaktuar se heroina ishte në posedim.
- 64) Nuk kishte arsye për të dyshuar në besueshmërinë e Vërtetimit për konfiskim të përkohshëm të gjësendeve, më datë 13 shkurt 2009. Trupi Gjykses vlerësoi si të besueshme mendimin e ekspertit të shkencës së shenjave të gishtërinjve nr. 2009-DKKO-055, të datës 24 qershor 2009.

- 65) Raporti i përpiluar nga A. O. dhe dorëzuar në gjykatë më 19 mars 2012 nuk ka vlerë provuese. Trupi Gjykses e trajtoi atë vetëm si informatë lidhur me burimin e provave, gjë e cila ishte dëshmia e këtij polici në cilësi të dëshmitarit. Prandaj, ishte e nevojshme që sërish të ftohej A. O. në shqyrtim kryesor dhe të merrej në pyetje lidhur me të gjitha faktet dhe rrethanat relevante rreth operacionit të kryer më 13 shkurt 2009 dhe para kësaj date.
- 66) Trupi Gjykses nuk kishte baza bazuar në prova të pranueshme për të diskredituar deklarin e N. M. se ai nuk mori pjesë në shpërndarjen e substancave të drogës dhe se shenjat e tij të gishtërinjëve në çantë janë vënë gabimisht.

***Përfundimi sa i përket N. M., M. S. dhe A. R. (akuza 1)***

- 67) Nuk ka prova të pranueshme për të përcaktuar se N. M., M. S. dhe A. R. kanë kryer veprën penale të klasifikuar si blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike dhe psikotrope në kundërshtim me nenin 229, para. 4, pika 1, KPK. Prandaj, nuk janë shpallur fajtorë për këtë pikë të akuzës.

***Përfundimi dhe vlerësimi ligjor i veprimit të Shefki Kayserli (akuza 1)***

- 68) Gjatë shqyrtimit kryesor është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më 13 shkurt 2009, rreth orës 15.00 në parkingun e Qendrës Tregtare Ben Af në Prizren, Sh. K. kishte në posedim dhe me qëllim të shitjes apo shpërndarjes së substancave narkotike në sasi prej 13.882 kg heroinë, brenda veturës së tij Mercedes ML me targa XX KS XX.
- 69) Trupi Gjykses erdhi deri te përfundimi se Sh. K. kreu veprën penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike dhe psikotrope në kundërshtim me nenin 229, para. 1, KPK. Sjellja e tij nuk përmbante elementet e veprës penale të paraparë me nenin 229 (4), KPK, siç është klasifikuar nga prokurori në aktakuzën e ndryshuar. Duhet nënvizuar se në pajtim me nenin 386 (2), KPPK, gjykata nuk është e lidhur me parashtrësat e prokurorisë sa i përket klasifikimit ligjor të veprimit.
- 70) Vepra penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike dhe psikotrope në kundërshtim me nenin 229 (1), KPK, parashihet si në vijim:

*Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron*

*për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjetë.*

71) Interpretimi i logjikshëm i kësaj dispozite sjellë deri te përfundimi se vepra penale e paraparë në nenin e cituar kryhet sa herë që bëhet një ndër veprimet vijuese sa u përket substancave në fjalë:

- Blerje me qëllim të shitjes apo shpërndarjes;
- Posedim me qëllim të shitjes apo shpërndarjes;
- Ofrim për shitje;

"or/apo" operatori sjellë një rezultat të vërtetë sa herë që *një apo më shumë* operandë janë të vërtetë.

72) Heroina definohet si substancë narkotike me Ligjin nr. 02/1-128 për Barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë (Tabela I – Bimët, Dorgat narkotike dhe substancat psikotrope me rrezik të lart që nuk përdoren në mjekësi dhe veterinari dhe që nuk lejohen në Kosovë)

73) Nuk ka dyshim që Sh. K. nuk ishte i autorizuar me ligj të posedojë droga të rrezikshme narkotike apo substanca psikotrope. Sidoqoftë, më 13 shkurt 2009, ai ishte në posedim të drogës narkotike, në sasi prej 13.882 kg heroinë (me përmbajtje prej së paku 50 % heroinë të pastër). Sasia e drogës tregon se posedimi i tij kishte për qëllim shitjen.

74) Trupi Gjykues erdhi deri te përfundimi se sjellja e Sh. K. nuk mund të klasifikohet si vepra penale e paraparë me nenin 229 (4), KPK ngase nuk është vërtetuar se ka vepruar si anëtar i një grupi.

#### ***Përfundimi dhe vlerësimi ligjor i veprimit të N. M. (akuza 2)***

75) Poashtu është vërtetuar se më 13 shkurt 2009, N. M., pa leje përkatëse, ishte në posedim të pistoletës Crvena Zastava, me kalibër M-57, 7.62 mm X 25 mm me numrin serik C211115, me karikatorë që përmbante 8 fishekë që i përkitnin N. M..

76) Më datën në fjalë, N. M. kreu veprën penale të pronësisë së paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 (2), KPK. Kjo akuzë për pronësi, kontroll apo përdorim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 (2), KPK, ndaj tij është hedhur poshtë

në pajtim me nenin 389, para. 4, KPPK ngase neni 3 (1.1.10) i Ligjit të Amnistisë (N.04/L-209) mbulon këtë veprim në kohën e theksuar në aktakuzë.

77) Në pajtim me nenin 489, para. 1, KPPK, pistoleta Crvena Zastava, me kalibër M-57, 7.62mm X 25mm, me numrin serik C211115, me karikatorin që përmbante 8 fishekë, është konfiskuar.

***Përcaktimi i dënimit ndaj Sh. K.***

78) Gjatë përcaktimit të dënimit për Sh. K., Trupi Gjykses kishte për obligim të merr parasysht qëllimet e dënimit të parapara me nenin 34, KPK, që janë si në vijim:

- Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe
- Të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

79) Përpos kësaj, Trupi Gjykses mori parasysht nivelin e lartë të përgjegjësië penale të Sh. K., motivin financiar për të kryer veprën penale dhe faktin se ai nuk është dënuar për vepër penale më parë.

80) Trupi Gjykses shqyrtoi faktorët rëndues si në vijim:

- Niveli i lart i qëllimit për të kryer veprën penale;
- Faktin se vepra penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike dhe psikotrope kryhet shpesh në Kosovë sot. Kjo gjë në mënyrë të rëndë ndikon në rendin publik, prandaj dënimi për këtë lloj veprë penale duhet të shërbejë si mjet i përgjithshëm për të përmbajtur të gjithë kryerësit e mundshëm nga kryerja e veprës penale;
- Sasia e madhe e substancave të rrezikshme narkotike, që gje cila flet për angazhimin serioz të të akuzuarit Sh. K. në sjelljen kriminale të këtij lloji.

81) Trupi Gjykses nuk gjeti ndonjë faktor lehtësues për të arsyetuar një dënim më të lehtë.

82) Duke marrë parasysht këto që u thanë më lart, Trupi Gjykses solli dënimin me tre (3) vjetë burgim dhe gjobën në shumën prej 5000 (pesë mijë) Euro ndaj Sh. K..

83) Në pajtim me nenin 39 (2), KPK<sup>13</sup>, afati kohor për pagesë të gjobës nga Sh. K. caktohet në periudhën prej 1 (një) muaji.

84) Në pajtim me nenin 73, paragrafi (1) dhe (3), KPK, koha e kaluar nga Sh. K. në paraburgim që nga 13 shkurt 2009 deri më 13 shkurt 2012 përfshihet në dënimin me burgim dhe kohën nga 14 shkurt 2012 deri më 21 shkurt 2012 përfshihet në dënimin me gjobë (barabartë me 120 Euro).

85) Në pajtim me nenin 229, para.5, KPK, konfiskohet sasia prej 13.882 kg heroinë;

### ***Shpenzimet***

86) Trupi Gjykues bazon vendimin për shpenzimet e procedurës penale mbi dispozitat ligjore të cituara në dispozitiv.

**17 maj 2014**

---

**Anna Adamska – Gallant**

**Proces-mbajtës**

---

---

<sup>13</sup> Dispozitivi gabimisht përmend “nenin 36” në vend të nenit 39.